

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
“KALOSHI” SH.P.K

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“KALOSHI” Sh.p.k**, është themeluar në bazë të aktit të themelimit sipas Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 “për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ i ndryshuar me Ligjin Nr 10475, datë 27.10.2011 dhe me Ligjin 129/2014 si dhe në Ligjin 9723. Datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit “ i ndryshuar me Ligjin Nr 9916, datë 12.05.2008, me Ligjin Nr. 92/2012, datë 27.09.2012, dhe me Ligjin Nr.8/2015 datë 19.02.2015 si dhe në Përputhje me legjislacionin në fuqi;

Neni 1

Themeluesit e Shoqërisë

Denis Kaloshi, lindur në Tiranë më 22.02.1997, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plota dhe juridike për të vepruar, mbajtës I letërnjoftimit me nr.personal J70222050G;

Neni 2

Emri i Shoqërisë

Është themeluar shoqëria **“KALOSHI” Sh.p.k**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do të quhet **“KALOSHI” Sh.p.k**.

Neni 3

Selia

Selia kryesore e shoqërisë do të jetë në Tiranë me adresë “Fusha Aviacionit” Rruga “Simon Gjoni” ZK 8220, Grand Park Residence, H6, Tirane, 1064 Tiranë.

Neni 4

Objekti

Shoqëria “KALOSHI” sh.p.k, do të ketë si objekt të veprimtarisë:

1. Ndërtime dhe rikonstruksione të objekteve civile, Industriale, tregtare, turistike, shëndetësore kulturore, sportive, vepra kullimi për vaditje, infrastrukturë shërbime komunale e urbane, ndërtime rrugore e hekurudhore, projektme të objekteve të sipër tregtuara, blerje dhe shitje trojesh, ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme, Prodhim transmetim shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike.



2. Aktiviteti në fushën e ndërtimit, projektimin e objekteve, punime muratore, punime tarrace, paisje me materiale të ndryshme ndërtimi, paisje impiante hidraulike, impiante elektrike, punime shtresash dyshemesh, riparime dhe rikonstruksionin;
3. Vlersimin e pasurive të paluajtshme, hartimi i raporteve të vlersimit të ndikimit në mjedis , për të kryer auditim mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problem mjedisor.
4. Shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të saj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria **“KALOSHI”** sh.p.k, kryen veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga asambleja e shoqërisë.

Neni 6

Drejtimi

Organet drejtuese të shoqërisë janë;

1. Asambleja e përgjithshme që përbëhet nga themeluesit e shoqërisë;
2. Administratori

Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë që emërohen për një periudhë prej 5(pesë) vjecare. Administrator i shoqërisë do të jetë:

Administratori i shoqërisë për periudhën 5-vjecare emerohet, **Denis Kaloshi**, lindur në Tiranë më 22.02.1997, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plota dhe juridike për të vepruar, mbajtës I letërnjoftimit me nr.personal J70222050G;

Neni 7

Kapitali

Kapitali fillestar i shoqërisë do të jete 100 lekë (njëqind lekë)

Ortaku i vetem themelues Z. Denis Kaloshi, do të zotërojë Kuotën me vlerë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Neni 8

Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me ditën e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar të shoqërive dhe mbyllet me 31 Dhjetor 2025



Neni 9


Të tjera

Shoqëria krijohet dhe do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi. Ligji 9901, datë 14.04.2008 I shoqëruar me shtesa dhe ndryshime nr. 129/2014, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligje të tjera që do të jenë në fuqi gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë.

Ky akt themelimi është i hartuar në tre ekzemplarë, pasi u lexua nga themeluesi i shoqërisë dhe u gjet konform vullnetit të tyre të plotë, firmoset rregullisht me datë 01/03/2025.

Themelues

Denis Kaloshi

A handwritten signature in blue ink, consisting of the name "Denis Kaloshi" written in a cursive style, followed by a large, stylized circular flourish.

